



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:265071

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644482

KE.nr.538/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit N.T.P. “Yespharma”, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Selim Nikqi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina” Sh.A., me seli në rr. Hazir Shala, nr.4 në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Armend Maka, me objekt kontesti, kompensim dëmi, vlera e kontestit 167,738.84 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 04.04.2024, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të paditurit merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.P. “Yespharma” dhe DETYROHET i padituri Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina” Sh.A., që në emër të kompensimit të dëmit, të shkaktuar me datën 14.08.2009, si pasojë e depërtimit të ujërave të zeza në depon e cila gjendet në Rr. “Shefqet Shkupi”, në Lagjen Kalabria në Prishtinë, t’ia paguaj paditësit shumën prej 167,738.84 €, (një qind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë euro e tetëdhjetë e katër cent), me kamatë në lartësi si për mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar që paguhet në bankat komerciale në Kosovë, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 16.09.2009, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi
- II. DETYROHET i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 8,500.00 €, (tetë mijë e pesëqind euro), brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Paditësi N.T.P. “Yespharma”, me datë 16.09.2009, pranë Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, ka paraqitur padi për kompensim dëmi kundër të paditurit Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina” Sh.A., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që të kompensoj paditësin në shumën prej 230.679.54 €, në emër të dëmit të shkaktuar nga mos funksionimi adekuat i pusëtës së kanalizimit të qytetit, e cila nuk ka mundur të përcjelljen adekuate të ujërave të zeza, me rastin e reshjeve atmosferike, që për pasojë ka rezultuar përmbytjen e deposë dhe prishjen e mallit – barnave farmaceutike dhe inventarit të paditësit. Ndërsa, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24.05.2011 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, ashtu që ka kërkuar kompensimin në emër të dëmit të lartcekur, në shumën prej 167.738.84 €, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin IV.C.nr. 341/2010 të datës 24.05.2011, në pikën I të dispozitivit, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.T.P. “Yespharma” dhe ka detyruar të paditurin që paditësit në emër të kompensimit të dëmit të ia paguaj shumën prej 81,788.60 €, me kamatë vjetore prej 3.5 %, nga dita e parashtrimit të padisë 16.09.2009 e deri në pagesën definitive të borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,042.50 €, në afat prej 7 ditës nga dita e marrjes së aktgjykimit. Në pikën II të dispozitivit kërkesëpadia e paditësit për shumën prej 81,788.60 €, së bashku me kamatën është refuzuar si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së palëve ndërgjyqëse, me Aktvendimin Ae.nr. 481/2012 të datës 09.01.2015, ka aprovuar ankesën e paditësit dhe të paditurit dhe ka prish aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, C.nr. 341/10 të datës 24.05.2011 dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim, e cila ka marr numrin e ri EK.nr. 62/15.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin EK.nr. 62/2015 të datës 10.03.2017, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit e cila konsiston në kompensimin e dëmit material lidhur me dëmtimin e mallërave medicinale të cilat si pasojë e depërtimit të ujërave të zeza në objektin ku pala paditëse kishte vendosur ato mallra janë dëmtuar tërësisht dhe me urdhrin e inspektorit

sanitar janë asgjësuar. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që shpenzimet e procedurës kontestimore i bartin secila palë veç e veç.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së palës paditëse, me Aktvendimin Ae.nr.110/2017 të datës 06.11.2019, ka aprovuar ankesën e paditësit dhe ka prish aktgjykimin e Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike të datës 10.07.2019 dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim, e cila ka marr numrin e ri EK.nr. 667/19, ndërsa pas transferimit të lëndës në Gjykatën Komerciale të Kosovës, kjo çështje kontestimore është evidentuar sipas numrit Ke.nr 528/22.

Përfaqësuesi i paditësit në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklarimeve dhe precizimit të kërkesëpadisë, duke theksuar që nga provat e administruara janë vërtetuar faktet vendimtare në mbështetje të kërkesës së paditësit. Ka shtuar që nga ky proces gjyqësor është vërtetuar fakti që paditësi ushtron veprimtarinë e qarkullimit të mallrave medicinale me shumicë dhe pakicë, se i njëjti është i licencuar dhe ka pasur leje nga Ministria e Shëndetësisë për magacinimn e mallit medicinal në lokalin të cilin paditësi e kishte marr me qira nga pronari i ndërtesës A.J..

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës ka theksuar që është provuar fakti që pronari i objektit ku ndodhej depoja ka qenë shfrytëzues i rregullt i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe rrjetit të kanalizimit, e gjithashtu është vërtetuar edhe fakti që edhe paditësi ishte shfrytëzues i shërbimeve të cilat i ka ofruar e paditura. Më tutje ka deklaruar që nga provat e administruara është vërtetuar fakti, që me datën 14.08.2009, ka ndodhur depërtimi i ujërave të zeza në depon e paditësit nga kanalizimi respektivisht nga kolektori kryesor, në të cilin ka qenë e kyçur ndërtesa ku ndodhej depoja e paditësit, ndërsa nga ekspertiza e hidros të datës 08.12.2009 të punuar nga eksperti S.I. dhe plotësimi i saj i datës 12.01.2010 është vërtetuar fakti se deri te depërtimi i ujërave të zeza në depon e paditësit ka ardhur si pasojë e mbylljes së kolektorit kryesor, e cila ka ndodhur si pasojë e mosmirëmbajtjes nga ana e të paditurës. Po ashtu nga ekspertiza e hartuar nga ana e grupit të ekspertëve Sh.L., S.D. dhe Z.S., si dhe nga shpjegimet e tyre është konstatuar që depërtimi i ujërave të zeza dhe shkaktimi i dëmit ka ardhur për shkak të mbylljes së kolektorit kryesor, i cili kishte ndodhur për shkak të mos mirëmbajtjes së tij nga ana e të paditurës.

Më tutje ka shtuar që në kohën kur kanë depërtuar ujërat e zeza në depon e paditësit, i njëjti kishte pasur mall medicinal në sasi të ndryshme, ku me urdhër të inspektoratit sanitar i

njëjti mall është asgjësuar për shkak të dëmtimit, ndërsa nga të lartcekurat rezulton se ekziston lidhja shkakore ndërmjet mbylljes së kolektorit kryesor dhe depërtimit të ujërave të zeza në depon e paditësit dhe shkaktimit të dëmit, konform nenit 154 dhe 184 të LMD-së.

Sa i përket lartësisë së kërkesës, ka theksuar që malli i cili është dëmtuar, kap vlerën prej 167,738.84 €, gjë e cila është vërtetuar sipas ekspertizës financiare të ekspertit Sh.M., andaj edhe e paditura ka obligim që të ia kompensoj në tërësi dëmin e shkaktuar paditësit në shumën prej 167,738.84 €, së bashku me kamatën ligjore nga data e shkaktimit të dëmit 14.08.2009 e deri në pagesën definitive. Ndërsa sa i përket pretendimit të paditurit se në rastin konkret, e njëjta nuk është përgjegjëse për kompensimin e dëmit, pasi që pronari i ndërtesës ku ishte depoja e paditësit kishte leje ndërtimi si dhe fakti që i njëjti është dënuar me aktgjykim penal për kyçje ilegale, ka theksuar që nuk janë relevante për çështjen, meqenëse të njëjtit në kohën kur ka ndodhur rasti kanë qenë konsumator të rregullt të shërbimeve të cilat i ka ofruar e paditura dhe se në kuptim të rregullave për konsumatorët e paditura ka pasur për detyrim që të ofroj shërbime të rregullta dhe pa pengesa, si dhe të mirëmbajë kolektorin.

I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I padituri në përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, si të pa bazuar në prova dhe ligj. Ka shtuar që në rastin konkret nga provat e administruara, përkatësisht nga Aktgjykimi P.nr. 56/2011 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i plotfuqishëm nga data 18.04.2019 është vërtetuar se deri tek shkaktimi i dëmit ka ardhur për shkak të veprimeve të H.J. i cili është pronari i shtëpisë dhe podrumit të cilën e ka marr në shfrytëzim paditësi. Nga ky aktgjykim është konstatuar që H.J. në podrumin e tij i ka dëmtuar instalimet e kanalizimit qendror, në atë mënyrë që ilegalisht, pa leje nga organi kompetent ka lidhur kanalizimin e objektit në sistemin e kanalizimit të paditurit, me ç'rast i ka dëmtuar gypat dhe e ka penguar rrjetin e kanalizimit duke kthyer ujin brenda në podrumin të cilin paditësi e ka përdorur për depo, duke i shkaktuar të njëjtit dëme të konsiderueshme materiale. Po ashtu ka theksuar që edhe nga ekspertizat e hidros, është konstatuar që kyçja ishte bërë në mënyrë joprofesionale dhe se gjykata në asnjë rrethanë gjendjen faktike të vërtetuar me aktgjykim të formës së prerë në procedurën penale, nuk mund ta ndryshoj në këtë procedurë, përmes ekspertizave të caktuara.

Më tutje i padituri ka theksuar që nuk mund të qëndroj konstatimi i grupit të ekspertëve, se kinse e paditura ka përgjegjësi në kuptimin e asaj se nuk ka dëshmuar se nga ndërmarrë veprime të mirëmbajtjes së rregullt të kolektorit apo se kinse nuk ka treguar kujdes për zgjidhjen më të përshtatshme për shkarkimin e ujërave nga kolektori, ngase dëmi i cili i është shkaktuar paditësit, ka ardhur për shkak të veprimeve të pronarit të shtëpisë, duke ia shtuar kësaj edhe faktin që asnjërit nga banorët e lagjes nuk i është shkaktuar ndonjë dëm material, nga çka rezulton se nuk qëndron pretendimi i grupit të ekspertëve që e paditura nuk ka vepruar sipas kornizës ligjore për trajtimin e lidhjeve ilegale të pa autorizuara nga paditësi, sepse e njëjta nuk ka qenë në dijeni për këtë pasi që në të kundërtën do ta inicionte rastin në prokurori.

I padituri po ashtu ka theksuar që për rastin konkret, sipas aktgjykimit penal, paditësi është udhëzuar që dëmin material ta realizoj në kontest civil ndaj të dënuarit H.J. dhe se padia e paditësit e paraqitur ndaj të paditurit K.R.U. Prishtina Sh.A., është e palejueshme, sepse paditësi ka qenë i obliguar që të veproj sipas aktgjykimit penal dhe dëmin ta kërkoj në raport me H.J.n dhe jo të paditurin, meqenëse në këtë çështje e paditura rezulton vetëm si palë e dëmtuar.

Më tutje përfaqësuesi i të paditurit ka theksuar që gjykata në kundërshtim me ligjin i ka aprovuar kërkesën e paditësit për kthim në gjendje të mëparshme, pasi që pas përfundimit të seancës në të cilën është konsideruar e tërhequr padia e paditësit, përfaqësuesi i të paditurit e ka parë përfaqësuesin e paditësit duke dorëzuar shkresë në gjykatë dhe se në këto rrethana ka qenë e pamundur që i njëjti në të njëjtën kohë ka qenë edhe i sëmure edhe të prezantoj në gjykatë, andaj gjykata ka qenë e obliguar që të marr parasysh pretendimet tona dhe përmes kamerave të gjykatës apo regjistrave të saj të pranimit të shkresave të vërtetoj një pretendim të tillë. I ka propozuar Gjykatës, që kërkesëpadinë e paditësit ta hudhë poshtë si të palejuar, ose ta refuzoj si të pabazuar.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Kërkesa e paditësit për kompensimin e dëmit nr.1081, e datës 28.08.2009; Përgjigjja në kërkesën për kompensim dëmi nr.1081/1 e datës 24.09.2009; Shikimi në foto dokumentacionin prej tri fotografive; Aktakuza PP.nr.541-9/2010, e datës 09.07.2010, e Prokurorisë Publike Komunale të Prishtinës; Aktgjykimi P.nr.56/11, i datës 13.12.2018, i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.I.nr.333/2019, i datës 18.04.2019; Ekstrakt nga librat e kontabilitetit e datës 02.03.2010, lëshuar për periudhën 2006 – 2010; Licenca nr.L1/2000/12/002, e datës 18.12.2008;

Procesverbali për kontrollin inspektues lëshuar nga Drejtorati i Inspekcionit në Prishtinë 09.nr.02/08/09, i datës 19.08.2009; Kërkesa e paditësit e datës 17.08.2009 drejtuar ATK-së; Kërkesa e datës 20.08.2009 nr.04-071226; Kërkesa e datës 18.08.2009 nr.02-53-22366; Procesverbali për kontrollin inspektues 09.nr02/53-22366, i datës 26.08.2009; Aktvendimi i datës 27.08.2009 – 02.nr53-22366; Fletë regjistrimi i mallit i NTP “Yesspharma”, i datës 14.08.2009; Procesverbali për inspektimin e kryer nr.000458, i datës 20.08.2009; Procesverbali për inspektimin e kryer nr.000459, i datës 25.08.2009; “Informata lidhur me të reshurat me datën 14.08.2009”, e datës 17.08.2009 – 63/03;

Vendimi nr.05-4113/2, i datës 17.12.2008; Kontrata mbi dhënien e lokalit me qira e datës 01.09.2008; Raportet mbi zjarrin e rënë të datës 17.08.2009 nr.405 dhe 408; Ekspertiza e Hidros e punuar nga eksperti S.I., e datës 08.12.2009 dhe plotësimi i saj i datës 12.01.2010; Aktvendimi i datës 14.04.2009 – 02.nr53-6788; Ekspertiza e datës 26.10.2021, e punuar nga grupi i ekspertëve Sh.L., S.D. dhe Z.S.; Ekspertiza financiare e punuar nga eksperti financiar F.T., e datës 10.02.2010; Përgjigjja e ekspertit financiar F.T., e datës 08.04.2010; Ekspertiza financiare e punuar nga eksperti Sh.M. e datës 06.04.2011 dhe Aktvendimi i lëshuar nga Drejtorati i Planifikimit të Urbanizimit dhe Ndërtimtarisë – Komunës së Prishtinës për dhënien e lejes ndërtimore nr.05-351-13319, të datës 01.06.2007.

Gjykata pasi ka bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Ekspertiza e Hidros e punuar nga eksperti S.I., me datën 08.12.2009, është konstatuar se me datën 14.08.2009 ka ndodhur përmbytja si pasojë e reshjeve atmosferike, me këtë rast kolektori kryesor ka dështuar ti kanalizoj ujërat e zeza dhe ato atmosferike, ku me këtë rast është krijuar shtypje hidrostатike në rrjetin e kanalizimit e cila shtypje nuk është dashur që të jetë meritore për depërtimin e ujit, por kjo ka ardhur si pasojë e pjesëve fazonike të cilat janë vendosur në brendësi të objektit dhe të cilat janë përgjegjësi e pronarit të objektit ku si pasojë ka ardhur deri tek depërtimi i ujit në lokalet e bodrumit – depos së produkteve farmaceutike. Eksperti po ashtu ka konstatuar që në aspektin teknik kjo ka ndodhur për shkak se është krijuar shtypje e vogël hidrostатike dhe se kjo shtypje ka ndikuar që lidhja e objektit me rrjetin e kanalizimit nuk ka mundur ti përballoj shtypjen për arsye se lidhja nuk ka qenë teknikisht e zgjidhur mirë dhe se pjesa fazonike ku ka depërtuar uji ka qenë e kualitetit të dyshimtë dhe se vendi ku ka ndodhë nuk bie në përgjegjësi të Kompanisë së Ujësjellësit Rajonal.

Nga plotësimi i ekspertizës të punuar nga eksperti S.I. me datën 12.01.2010, është konstatuar që rrjeti i kanalizimit, gjegjësisht kolektori kryesor i këtij rrjeti ka dështuar ti kanalizoj ujërat si pasojë e reshjeve dhe mbingarkimit të rrjetit, me ç'rast ka ardhur deri te ngritja e nivelit të ujërave në rrjet, e cila ka rezultuar me depërtim në depo, duke konstatuar që si pasojë e mbylljes së kolektorit kryesor ka ardhë deri te përmytja e depos dhe se po të mos kishte ndodhur mbyllja e kolektorit gjegjësisht ngritja e nivelit të ujërave në rrjetin e kanalizimit atëhere nuk do të kishte ardhur deri tek përmytja e depos.

Nga Ekspertiza e punuar nga grupi i ekspertëve Sh.L., S.D. dhe Z.S. të datës 26.10.2021, është konstatuar që e paditura KUR "Prishtina", nuk ka dëshmuar se ka ndërmarrë veprime të mirëmbajtjes së rregullt të kolektorit të kanalizimit (pastrimi i rrjetit të kanalizimit dhe riparimi i pusetave) për lokacionin në fjalë në intervalin kohor kur ka ndodhur dëmi material në podrum siç parashihet me legjislacion; nuk ka treguar kujdes për zgjidhjen më të përshtatshme të shkarkimit të ujërave të kanalizimit nga kolektori aktual në Përroskën e Matiçanit duke u bazuar në kriteret teknike si dhe nuk ka vepruar sipas akteve ligjore dhe rregullative për trajnimin e lidhjeve të paautorizuara nga pala paditëse.

Ekspertët po ashtu kanë konstatuar që paditësi nuk është paraqitur tek e paditura për të lidhur kontratën për shërbimet e ujit dhe kanalizimit siç përcaktohet me legjislacion dhe se nga data 01.09.2008 e deri me datën 28.02.2009 nuk është faturuar për shërbimet e ujit dhe kanalizimit, si dhe i njëjti nuk ka pasur kujdes të shuar kur i ka vendosur produktet farmaceutike në bodrumin e marr me qira, pasi që lagja Kalabria sipas deklarimeve të zyrtarëve institucional dhe qytetarëve në vazhdimësi ka probleme me përmytje sidomos kur të reshurat atmosferike janë prezente dhe nuk është faktuar si ka arritur paditësi që të merr vendimin mbi pëlqimin sanitar nga organet përkatëse pa u përmbushur në tërësi kërkesat ligjore për këtë çështje. Ndërsa sa i përket përgjegjësisë së H.J., ekspertët kanë konstatuar që i njëjti ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin me rastin e lidhjes së paautorizuar në rrjetin e kanalizimit. Po ashtu është konstatuar që objekti ku është shkaktuar dëmi material është ndërtuar pa leje ndërtimore ose pëlqim urbanistik dhe pa pëlqim për kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Ndërsa lidhja e bodrumit me pusetën e kolektorit të kanalizimit nuk është mbyllur (neutralizuar) sipas kriterëve teknike e për pasojë ka mundësuar depërtimin e ujërave fekale në bodrumin e dhënë me qira me rastin e ngritjes së nivelit të ujit në Pusetën e Kolektorit të Kanalizimit si pasojë e bllokimit të rrjetit të kanalizimit.

Nga Ekspertiza financiare e datës 10.02.2010 e punuar nga eksperti financiar F.T., është konstatuar që vlera e mallit farmaceutik, sipas fletëregjistrimit është në shumën prej 202,670.10 €, shpenzimet e krijuara për asgjësimin e mallit dhe ruajtjen e barnave është në shumën prej 3,249.94 € dhe gjithsej dëmi i shkaktuar arrin në shumën prej 205,920.00 €.

Nga Ekspertiza financiare e datës 06.04.2011 e punuar nga eksperti financiar Sh.M., është konstatuar që dëmet materiale farmaceutike të llogaritura – konstatuara në bazë të librave – evidencave kontabël sipas çmimit shitës të datës 14.08.2009, janë në vlerë prej 166,428.60 €, si dhe 1,310.24 € në emër të shpenzimeve ku gjithsej dëmi i shkaktuar arrin në shumën prej 167,738.84 €.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.56/11, të datës 13.12.2018, i vërtetuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PA1.nr.333/2019, i datës 18.04.2019, rezulton se H.J., i lindur me datën ... nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me kusht në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse nuk kryen veprën tjetër penale për kohën e verifikimit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, për veprën penale të Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 292 par. 1 të KPK-së, sepse prej datës së pavërtetuar, gjer me datën 14.08.2009 në Prishtinë, në podrumin e shtëpisë së të pandehurit e cila gjendet në Prishtinë, lagja Emshir, Rr. "...", i njëjti ka dëmtuar instalimet e kanalizimit qendror, në atë mënyrë që ilegalisht, pa leje nga organi kompetent e ka lidhur kanalizimin e objektit – podrumit në sistemin e kanalizimit të kompanisë së Ujësjiellit Rajonal "Prishtina", me ç'rast i ka dëmtuar gypat dhe ka penguar rrjetin e kanalizimit, duke u kthyer uji brenda në podrumin e lartcekur-depon për barna të firmës NTP 'Yespharma', duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

Nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse dhe provat e administruara, rezulton se për asnjërën palë nuk ishte kontestues fakti se me datën 14.08.2009, në depon e paditësit e cila gjendet në Rr. "Shefqet Shkupi", në Lagjen Kalabria në Prishtinë, kanë deportuar ujërat e zeza duke i shkaktuar dëm material, mirëpo në rastin konkret kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte nëse përgjegjësia për shkaktimin e dëmeve si pasojë e depërtimit të ujërave të zeza, bie në barrë të paditurit, respektivisht nëse ekziston baza ligjore e krijimit të detyrimit dhe kompensimit të paditurit ndaj paditësit.



Duke u bazuar në të gjeturat e ekspertit S.I. dhe grupit të ekspertëve Sh.L., S.D. dhe Z.S. si dhe nga provat tjera të lëndës, gjykata ka ardhur në përfundimin se deri te shkaktimi i dëmit në depon e paditësit, ka ardhur si pasojë e lëshimeve të paditurit. Meqenëse pala e paditur është kompetente për furnizimin me ujë si dhe trajtimin dhe largimin e ujërave të zeza dhe e ushtron këtë veprimtari, rezulton se e njëjta ka për detyrim edhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ushtrimi i veprimtarisë.

Duke marr për bazë që raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse është krijuar në vitin 2009, për vendosje në këtë çështje juridike, Gjykata i është referuar Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të datës 30 mars 1978 (tutje LMD).

Sipas nenit 154 par.2 të LMD-së përcaktohet se: *“Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmi për ambientin përgjigjet pavarësisht nga faji. Për dëmin pavarësisht nga faji përgjigjet edhe në raste të tjera të parashikuara me ligj”*. Ndërsa me paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: *“Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Në rastin konkret, gjykata vlerëson se e paditura mban përgjegjësi për faktin se dëmi i shkaktuar qëndron në lidhje kauzale me veprimtarinë e të paditurës dhe se dëmi është shkaktuar si pasojë e mosmirëmbajtjes së rregullt të kolektorit të kanalizimit përkatësisht mos pastrimit të rrjetit të kanalizimit dhe riparimit të pusetave, ku kolektori kryesor ka dështuar që ti kanalizoj ujërat që kanë ardhur si pasojë e reshjeve dhe nga ngritja e nivelit të ujit në rrjet, është mbyllur kolektori kryesor dhe si rrjedhojë edhe është përmytur depoja e paditësit, me ç’rast rezulton se i padituri ka përgjegjësi objektive për shkaktimin e dëmit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, përgjegjësia për dëmin e shkaktuar bie mbi të paditurin, sepse veprimtaria të cilën e ushtron i padituri kualifikohet si veprimtari me rrezik të shtuar, e cila dallon nga veprimtaritë tjera, gjatë ushtrimit të cilave nuk ekziston fare rrezik nga shkaktimi i dëmit. Vet fakti se veprimtaria e të paditurit përbën veprimtari të tillë, mbi të cilën nuk mund të ushtrohet kontroll i plotë dhe gjatë së cilës, në çdo moment dhe në çdo kohë, pa asnjë lëshim të asnjërës palë, mund të paraqitet rreziku dhe mund të shkaktohen aksidente me pasoja të rënda, e kualifikon veprimtarinë e të paditurës si veprimtari me rrezik të shtuar, e cila krijon përgjegjësi për të gjitha dëmet e shkaktuara që rezultojnë apo ndërlidhën me furnizimin,

përkatësisht me trajtimin dhe largimin e ujërave të zeza pavarësisht nga faji (përgjegjësi objektive).

Pretendimi i përfaqësuesit të të paditurës se dëmi në rastin konkret ka ardhur pa fajin e të paditurës, respektivisht nga veprimet e pronarit të shtëpisë i cili edhe është shpallur fajtor dhe është dënuar në procedurën penale, gjykata e vlerëson si të pabazuar, sepse në rastin konkret paditësi nuk ka ndërmarrë asnjë veprim me të cilin do të mund të shkaktonte dëm dhe po ashtu i njëjti nuk mund të mbajë përgjegjësinë për veprimet e të tjerëve. Andaj gjykata vlerëson se përgjegjësia për dëmin e shkaktuar bie mbi të paditurin, për shkak se i njëjti ushtron veprimtari me rrezik të shtuar dhe ka qenë i obliguar që të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e çfarëdo rrezikut, madje është dashur t'i parashoh të gjitha veprimet dhe rrethanat nga të cilat mund të vjen rreziku dhe të ndërmarrë masa adekuate për evitimin e rrezikut në çdo rrethane dhe nga çdo veprim.

Në veprimtarinë me rrezik të shtuar, rreziku dhe përgjegjësia supozohen andaj çdo dëm i pësuar nga këto veprimtari, bie në përgjegjësi të ushtruesit të veprimtarisë së tillë. Lidhur me këtë në nenin 173 të LMD-së, përcaktohet se: *“Dëmi i lidhur me sendin e rrezikshëm, respektivisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send respektivisht nga kjo veprimtari me përjashtim në qoftë se provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit”, (presumimi i kuazalitetit)*. Prandaj, bazuar në këtë dispozitë, përgjegjësia e të paditurës për dëmin e shkaktuar mund të largohet nga ajo, vetëm nëse e paditura e provon se dëmi nuk është shkaktuar si pasojë e furnizimit – trajtimit të ujërave, përkatësisht se dëmi nuk është shkaktuar nga veprimtaria e të paditurit apo nëse edhe përkundër faktit se ajo i ka marrë të gjitha masat e duhura, dëmi nuk do të mund të mënjanohej në asnjë mënyrë, respektivisht duhet ta provojë se dëmi ka ndodhur absolutisht pa fajin e saj dhe se ajo nuk ka mundur ta parashoh dhe as ta parandalojë atë, si dhe të provojë se dëmi ka ndodhur ekskluzivisht me fajin dhe nga veprimet e paditësit. Barra e të provuarit në këtë rast bie mbi të paditurën.

Meqenëse në rastin konkret e paditura nuk ka ofruar prova, më të cilën do ta vërtetonte se ajo nuk është përgjegjëse për dëmin, duke aplikuar nenin 174 të LMD-së, i cili përcakton se: *“Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me te. Zotërues konsiderohet poseduesi i sendit, si dhe personi shoqëror juridik që ka të drejtë disponimi, respektivisht të drejtë shfrytëzimi të përkohshëm”,* Gjukata vlerëson se pretendimet e të paditurës, lidhur me gjendjen faktike

respektivisht shkakun e dëmit, janë të pabazuara dhe se e paditura është përgjegjëse për dëmin e pësuar nga paditësi.

Nga provat e shqyrtuara gjykata ka ardhur në përfundimin se në mënyrë kumulative janë përmbushur kushtet e cituara në dispozitat e lartcekura të LMD-së dhe meqenëse veprimtaria që ushtron pala e paditur është veprimtari me rrezik të shtuar në bazë të rregullave mbi përgjegjësinë pavarësisht fajit (objektive), rezulton se pala e paditur ka për detyrim kompensimin e dëmit të shkaktuar. Rrjedhimisht gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe në dispozitat ligjore të cituara ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e palës paditëse është e bazuar.

Prandaj, duke ju referuar Nenit 189 të LMD-së, i cili përcakton se: *“I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar. Shuma e dëmit të thjeshtë caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor me përjashtim të rastit kur ligji urdhron diçka tjetër. Gjatë vlerësimit të shumës së përfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi. Kur sendi është asgjësuar ose është dëmtuar për shkak të veprës penale të kryer me dashje gjykata mund të caktojë shumën e kompensimit sipas vlerës që ka pasur sendi për të dëmtuarin”*, gjykata vlerëson se në rastin konkret ekziston obligim i të paditurit që paditësit t’ia paguaj kompensimin e dëmit material në shumën prej 167,738.84 €, për dëmet e pësuar si pasojë e përmbajtjes së depos së paditësit.

Lartësinë e shumës së gjykuar, gjykata e përcaktoi duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit financiar Sh.M., të cilës gjykata ia fali plotësisht besimin, pasi që ekspertiza ishte bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe për më tepër palët ndërgjyqëse gjatë procedurës të rigjykitimit, nuk kanë pasur propozime të reja.

Gjykata nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet e të paditurit të paraqitura në seancën e shqyrtimit kryesor sa i përket bazueshmërisë lidhur me aprovimin e kërkesës së paditësit për kthim në gjendje të mëparshme, meqenëse arsytet për të cilat gjykata ka aprovuar kthimin në gjendje të mëparshme janë dhënë në Aktvendimin e veçantë Ke.nr 528-22 të datës 13.02.2023. Po ashtu gjykata e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e të paditurit për shtyrjen e seancës së shqyrtimit kryesor si dhe kërkesën për nxjerrjen e video kamerave dhe regjistrave të gjykatës për të vërtetuar shkaqet e mungesës së paditësit në seancën e datës 06.12.2022, për faktin që një

kërkesë e tillë është tërësisht e pabazuar dhe nuk gjen mbështetje ligjore konform dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Gjykata nuk ja fali besimin ekspertizës financiare të punuar nga ekspertit z. F.T., pasi që e njëjta nuk ishte në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa provat tjera të administruara lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata i ka vlerësuar mirëpo ka gjetur se të njëjtat nuk kanë ndikim për vendosje në këtë çështje juridike, meqenëse kontestuese ndërmjet palëve ishte vetëm përgjegjësia e të paditurit për kompensimin e dëmit.

Gjykata duke iu referuar nenit 277 të LMD-së, e miratoi kamatëvonesën e kërkuar, ashtu që e detyroi të paditurin që përveç shumës në emër të kompensimit, paditësit t'ia paguajë edhe kamatën ligjore siç e paguajnë bankat komerciale të Kosovës, për deponimet prej një viti, pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë 16.09.2009, e deri në pagesën definitive.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.5 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi dhe atë për përfaqësim në 10 seanca të mbajtura, në shumën prej 4,000.00 € (400 € x 10), për pagesën e taksës gjyqësore shumën prej 500 €, për pagesën e taksës për vendimin gjyqësor shumën prej 500 €, pagesën për ekspertizën e hidros në shumën prej 1000 €, pagesën për grupin e ekspertëve shumën prej 1500 €, si dhe shumën prej 1000 € në emër të pagesës për dy ekspertiza financiare, gjithsej shumën totale në vlerë prej 8,500.00 €.

Nga arsyet e cekura më lart, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.538/22, datë 04.04.2024

Gjyqtari  
Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.